

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

INTERLOGISTIC

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K21605003M

NUIS/NIPT

Autostrada Tirane-Durres, Rruga Dytesore Km 9, Godine 3 kateshe

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692081956

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

hido.ed@ilog.al

E-mail

Administrator i deleguar Lorina Lako

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2024/03/11

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0696062914

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-97735-03-07-2024

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

Shoqëria Rajonale Ujësjetillës Kanalizime Elbasan SH.A

Vlera e përllogaritur e prokurimit

Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

1499600

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Blerje materiale kancelarie për nevojat e shoqërisë

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2024/03/21

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmëri të kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2024/03/21

Numri i njoftimit

Kodi CPV

REF-97735-03-07-2024

22852000-730125110-530125120-830192124-

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

1. Ligji nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar
 2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285 date 19.05.2021 “Pe?r miratimin e Rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,
 3. Direktiva nr. 24/2014 “Pe?r prokurimin publik” Këshillit të Europës:
 4. Praktika e KPP-së (vendimi i KPP-së Nr. 200/2022, datë 25.02.2022, vendimi i KPP-së Nr. 675/2023, datë 26.07.2023, vendimi i KPP-së Nr. 485/2022, datë 25.04.2022, vendimi i KPP-së Nr. 543/2023, datë 29.06.2023, vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 68/2024 datë 19.01.2024)
 5. N1. Ligji nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar
 2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285 date 19.05.2021 “Pe?r miratimin e Rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,
 3. Direktiva nr. 24/2014 “Pe?r prokurimin publik” Këshillit të Europës:
 4. Praktika e KPP-së (vendimi i KPP-së Nr. 200/2022, datë 25.02.2022, vendimi i KPP-së Nr. 675/2023, datë 26.07.2023, vendimi i KPP-së Nr. 485/2022, datë 25.04.2022, vendimi i KPP-së Nr. 543/2023, datë 29.06.2023, vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 68/2024 datë 19.01.2024)
 5. Njoftimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 8297/3 prot datë 23.01.2020 me lëndë “Njoftim”
jofitimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 8297/3 prot datë 23.01.2020 me lëndë “Njoftim”
-

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit



- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkonti pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Përshkruani rrethanat e faktit.

? Në shtojcën nr. 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” të dokumenteve standarte të tenderit është kërkuar afati i levrimit nga ana Juaj si më poshtë:

Afatet e lëvrimit: Brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga data e nënshkrimit të kontratës.

? Në shtojcën nr. 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumenteve standarte të tenderit është kërkuar si më poshtë:

“2.3.1 Në datën dhe orën e hapjes së ofertave, çdo OE pjesëmarrës, duhet të paraqesë mostrat e kërkuara nga AK, sipas tabelës në Shtojcën 5.

Mosparaqitja e mostrave, apo paraqitja e mostrave që nuk përputhen me specifikimet teknike, përbën kusht për s’kualifikim”

? Në shtojcën nr. 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumenteve standarte të tenderit është kërkuar si më poshtë:

“2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetim/deklarate/autorizim prodhuesi ose të distributorit të autorizuar për artikujt e kancelarisë, bojë printeri (toner) dhe letrën. Dokumentet duhet të përmbajnë të dhëna të plota si: telefoni/e-mail/website, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”

Tonerat duhet të kenë të gdhendur në trup emrin e tonerit përkatës të cilët janë element sigurie

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

Shoqëria “Interlogistic” Sh.p.k me Nipt K21605003M përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm Z. Edmond Hido, në vijim të procedurës së prokurimit publik “Procedure e hapur e thjeshtuar”, shpallur nga Autoriteti Kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sha, me objekt: “Blerje materiale kancelarie për nevojat e shoqërisë”, me numer

REF-97735-03-07-2024, me fond limit 1,499,600.66 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind presje gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë, pa TVSH, publikuar më datë 08.03.2024, referuar në afatin 7 (shtatë) ditor të parashikuar nga Ligji nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” konkretisht Neni 110 pika 2 i cili citon “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”, lidhur me të drejtën e ankimit pas publikimit të dokumenteve standarte të tenderit, po ju parashtrajmë në vijim arsyet ligjore ku bazohen këto kundërshtime:

? Në shtojcën nr. 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” të dokumenteve standarte të tenderit është kërkuar afati i levrimit nga ana Juaj si më poshtë:

Afatet e lëvrimit: Brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në lidhje me sa është kërkuar nga ana e juaj, pretendojmë se ky afat është tepër i shkurtër, kjo pasi bëhet fjalë për furnizimin me sasi të konsiderueshme të artikujve (kancelari, letër si dhe tonera) të cilët importohen nga furnitorë? te? ndryshe?m nde?rkombe?tare?. Duke qe?ne? se operatorët ekonomik për artikujt objekt prokurimi i kësaj procedure duhet të marrin furnizimin nga furnitorë të huaj dhe duke marrë në konsideratë kushtet aktuale globale të shkaktuara nga Pandemia Covid-19, lufta në Ukrainë si dhe lufta në Palestinë, kaosi i shkaktuar lidhur me transportin dhe rritja shumë e madhe e çmimeve të tij, e bëjnë shumë të vështirë që malli të merret nga jashtë shtetit dhe të lëvrohet në adresën tuaj brenda afatit të përcaktuar në DST. Të ndodhur në kushtet e krizës botërore për sa i përket transportit dhe lëvrimit të mallrave, kërkojmë që afati i lëvrimit të jetë minimalisht 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës. Theksojmë se kërkesa e AK është në shkelje të Ligjit LPP dhe Neni 40 të Rregullave të Prokurimit Publik. Për të gjitha sa u parashtruan mësipër, në zbatim dhe pë?rputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Vendimin nr.285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, kërkojmë që Autoriteti Kontraktor dhe Komisioni i Prokurimit Publik, të ndryshojë kriterin e mesiperm si të pabazuar në ligj dhe në prova”.

Ky pretendim i joni ligjerohet dhe nga vendimi i KPP-së Nr. 200/2022, datë 25.02.2022, vendimi i KPP-së Nr. 675/2023, datë 26.07.2023

? Në shtojcën nr. 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumenteve standarte të tenderit është kërkuar si më poshtë:

“2.3.1 Në datën dhe orën e hapjes së ofertave, çdo OE pjesëmarrës, duhet të paraqesë mostrat e kërkuara nga AK, sipas tabelës në Shtojcën 5.

Mosparaqitja e mostrave, apo paraqitja e mostrave që nuk përputhen me specifikimet teknike, përbën kusht për s’kualifikim”

Nga sa më sipër në lidhje me këtë kriter theksojmë faktin se Autoriteti Juaj kontraktorë nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, të paraqesin në datën dhe orën e caktuar mostra për të gjithë artikujt. Në bazë të ligjit të prokurimeve në fuqi autoriteti kontraktor për të garantuar mallra/produkte konformë standardeve që përcaktojnë kanë të drejtë të kërkojnë që produktet e caktuara të sillen si mostra, por në asnjë rast nuk jep të drejtën e autoriteteve kontraktore të kërkojnë mostra për të gjitha produktet të cilat edhe në sasi, në kuptimin e lëvrimit të mallrave në përfundim të procedurës së prokurimit, janë në sasi të vogla. Nuk ka sens logjik dhe as juridik paraqitja e mostrave për të gjithë artikujt e kërkuar. Në këtë aspekt ky përcaktim i bërë në DST vjen në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore të prokurimeve të

janë në fuqi.

Ky pretendim i joni përcaktohet dhe nga vendimi i KPP-së Nr. 485/2022, datë 25.04.2022.

? Në shtojcën nr. 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumenteve standarte të tenderit është kërkuar si më poshtë:

“2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetim/deklarate/autorizim prodhuesi ose të distributorit të autorizuar për artikujt e kancelarisë, bojë printeri (toner) dhe letrën. Dokumentet duhet të përmbajnë të dhëna të plota si: telefoni/e-mail/website, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”

Në lidhje me kriteret e lartcekura, të kërkuar nga ana e juaj, gjykojme që janë kërkesa të ekzagjeruar, kufizuese dhe jo në proporcion me objektin e kontrates.

Për të realizuar këto kërkesë, OE pjesëmarrës, duhet të bashkëpunojnë vetëm me prodhuesit apo me distributorët e autorizuar. Nderkohë, referuar artikujve të publikuar, objekt prokurimi kemi të bëjmë me artikuj të imet e të thjeshtë kancelarie, të cilat mund të sigurohen lehtësisht nga furnitorë të pafund, të cilët nuk operojnë mbi baza distribucioni si dhe nuk kanë katalogje të publikuara. Kërkesa për katalogje apo skedë teknike, nga prodhuesi apo distributor i autorizuar, ka kuptim dhe është përdorur nga shumë AK, për artikullin letër fotokopje/printimi, pasi specifikimet teknike të kërkuara për këtë produkt, nuk verifikohen dot me sy të lirë nga AK. Ndërsa për produktet e thjeshta të kancelarisë, AK kanë të gjithë instrumentat, që të verifikojnë përputhjen e produkteve të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara. Ju sjellim në vëmendje Rekomandimin mbi hartimin e kritereve të kualifikimit për procedurat e prokurimit punëra, mallra, shërbime nga APP të datës 24.12.2021, ku APP përcakton në pikën 16 se “për procedurat e hapura të thjeshtuara, si procedura në fjalë, AK duhet të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimit. Së fundmi, sjellim në vëmendje të autoriteteve/enteve kontraktore se në rastin e procedurave të hapura të thjeshtuara, të përcaktojnë kriteret sa më të thjeshta pranimit, për operatorët ekonomike, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm, duke mbajtur në vëmendje përcaktimet e nenit 55, pika 4, të RRPP, ku parashikohet: Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kriteret e sipërcituara, jo vetëm që nuk nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencen e lirë, por perkundrazi, kufizojnë pjesëmarrjen, pasi lejojnë të marrin pjesë vetëm OE që furnizohen nga prodhuesit apo distributorët e autorizuar. Këto kërkesa nuk lidhen me garantimin e cilësisë. Për këtë arsye, kërkojmë modifikimin e këtyre kritereve.

Ky pretendim i joni përcaktohet dhe nga vendimi i KPP-së Nr. 543/2023, datë 29.06.2023.

Gjithashtu shtojmë se në lidhje me kërkesën për autorizimin e prodhuesit për artikujt Tонера është në kundërshtim përse vijon më poshtë.

Ky kriter kualifikues ku operatori ekonomik duhet të vertetojë që është i autorizuar nga prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar për tregtimin e brandeve që janë pjesë e këtij prokurimi, është një kriter që në bazë të vendimit të formës së prerë si mëposhtë është i ndaluar:

Duke ju referuar vendimit nr. 00-2015(42) datë 23.01.2015, Gjykata e Lartë në çështjen administrative me palë paditëse shoqëria Marketing & Distribution sh.p.k, palë të paditur Komisionin e Prokurimit Publik dhe me palë të tretë Ministrinë e Brendshme me objekt shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik dhe të procedurave të prokurimit publik Blerje toner për Kryeministrinë, Ministrinë dhe institucionet në varësi të tyre, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik që kishte rrëzuar ankimin e operatorit ekonomik Marketing & Distribution Sh.p.k i cili kundërshtonte kriterin kualifikues të Formës së Autorizimit nga Prodhuesi.

Në paragrafin 33 të vendimit të Gjykatës së Lartë për një rast precedent, bashkëngjitur kësaj

kërkëse, Gjykata e Lartë thekson që sipas neneve 20, 23 dhe 46 të ligjit nr 9643/2006, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se autoritetet kontraktore gjatë percaktimit të kriterëve të veçanta duhet të shmangin cdo kerkese apo procedurë që lidhet me kualifikimin e operatoreve ekonomike, e cila përbën diskrimin ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktoreve ose ndaj kategorive të tyre. [...] Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpermendura, urdhërojnë se percaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve . Gjykata vijon në paragrafin 37 duke u shprehur se Duke u kthyer në rastin konkret evidentohet se kriteri objekt kundërshtimi nga pala paditese "paraqitja e formes së autorizimit nga prodhuesi nuk plotëson kushtet për të qënë një kriter specifik kualifikues në përputhje me ligjin.

Sipas Gjykatës së Lartë origjinaliteti i bojerave mund të vërtetohet me dokumenta ekuivalente: vërtetimi i origjinalitetit të bojerave [...] mund të garantohej me pajisjen e tyre me vulen e origjinalitetit të pahapur dhe jo të rimbushura" duke vijuar në paragrafin 38 të vendimit që kërkesa për paraqitjen e formës së autorizimit nga prodhuesi si kriter kualifikues, nuk mund të jetë i vetmi mjet që të mundësojë garantimin e origjinalitetit të mallit , kjo duke e mbështetur argumentimin e saj edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit European në çështjen Procureur du Roi v. Dassonville 1974.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se mospërzgjedhja - e kriterit të veçantë Forma e Autorizimit nga Prodhuesit në përputhje me të gjithë elementet që e detyron ligji në çështjen objekt gjykimi ka bërë që autoriteti kontraktor të duket sikur e ka parazgjedhur paraprakisht kandidatin fitues, ç'ka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë”.

Duke iu referuar Vendimit të Gjykatës dhe arsyetimit të tyre ligjorë, kërkojmë nga ana e Autoritetit Kontraktor të ndryshojë Dokumentat Standarte të Tenderit duke revokuar kriterin kualifikues ku operatori ekonomik duhet të vertetoje që është i autorizuar nga prodhuesi dhe nga distributori i autorizuar.

Gjithashtu duke ju referuar ligjit të prokurimit i cili ne thelb ka për qëllim të nxisë pjesëmarrjen dhe të trajtojë të gjithë OE në mënyrë të barabartë, ky kriter shihet më shumë si favorizues për ndonjë OE sesa vertetues i produkteve të kërkuara. Ky kriter e pamundëson pjesëmarrjen në tender të shumë ofertuesve. Autoriteti Kontraktor ka mënyra të tjera për të vertetuar origjinalitetin e produkteve si:

1. Vertetohet me anë të pullës së sigurisë së markës që është unike.
2. Kodi OEM i cili është unik dhe i stampuar në kuti
3. Duke kërkuar deklaratë origjinaliteti për produktin (nga ku rrjedh dhe detyrimi i OE, që produktet në raste të fitimit të tenderit të jenë konform, dhe nga ku lind dhe siguria e juaj për produktet që do të merrni në dorezim)
4. Duke kërkuar katalog teknik për produktet që kërkohen
5. Duke marrë eksperte të jashtëm të liçensuar për këtë qëllim

Në funksion të heqjes së kriterit të sipërcituar kemi edhe praktikën e KPP-së konkretisht referuar Vendimit KPP-së, nr. 222/2017, (bashëkangjitur formatit të ankesës) ku ky i fundit i referohet Vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ka vendosur që kriterë të tilla si: autorizim prodhuesi i distributori të autorizuar janë diskriminuese, jo në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe si të tilla, duhet të hiqen.

Gjithashtu referuar dhe Vendimit KPP-së nr. 128/2020, vendim i cili shprehimisht e sheh këtë kriter si një kriter që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe vendos heqjen e këtij kriteri nga procedura e prokurimit.

Agjencia e Prokurimit publik, në funksion të heqjes së autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar, me shkresën nr. 4521/2 prot datë 23.07.2021, drejtuar operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” shpk është shprehur konkretisht: “APP ka rekomanduar autoritetet kontraktore që,

autorizimi i prodhuesit/distributorit të autorizuar nga prodhuesi është një prej mundësive që dëshmon origjinalitetin e mallrave, por në çdo rast ky autorizim nuk duhet të lidhet me një marke/prodhues të caktuar, me qëllim që të mos kufizohet pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë që ofrojnë mallrat e prodhuesve të ndryshëm nga prodhuesi i pajisjes, por që janë të përshtatshme në pajisjet që disponon autoriteti kontraktor”

Së fundmi duke iu referuar dhe Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 21.10.2020 me numër prot. 6732, me lëndë “Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të Dokumenteve Standarte të Tenderit dhe verifikimit të procedurave të prokurimit për mallra, punë, shërbime” rekomandim i cili shprehimisht ndalon kërkimin e dokumentacionit të paleve të treta që nuk janë pjesë e konkurimit në procedurën që po aplikohet.

Sa më sipër kërkojmë heqjen e kërkesës për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të prodhuesit për artikullin toner si dhe kancelari.

Vendosja e një kriteri të tillë bie në kundërshtim;

? Në nenin 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

? Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

? Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë

një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Nga interpretimi i bazës ligjore të sipercituar, kriteret për kualifikim vendosen për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Modifikimi i kriterit të lartpërmendur nga ana e autoritetit bën të mundur shmangien në kufizimin e konkurrueshmërisë duke mundësuar një konkurrim të drejtë, të hapur dhe sa më gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminuese për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar.

? Gjithashtu në shtojcën 5 “Specifikimet teknike” është kërkuar nga ana Juaj si më poshtë:
SPECIFIKIMET TEKNIKE

KËRKESAT PËR ARTIKUJT E NEVOJSHËM DHE SPECIFIKIMET PËRKATËSE

Nr. Emërtimi i artikujve Njësia Sasia Specifikime

1	Makinë hapëse vrimash jo më pak se 30 fletë mundësojë hapjen e jo më pak se 30 fletë njëherësh	copë	20	Të jetë cilësore, dhe të
2	Kapëse me veshë 41 mm	copë	100	Të jenë cilësore, material metali sustë.
3	Kapëse me veshë 51 mm	copë	60	Të jenë cilësore, material metali sustë.
4	Gomë fshirëse	copë	30	Të jenë cilësore në fshirjen e bojës së stilolapsave dhe të lapsave.
5	Llastik lekësh pako	20		Të jenë material cilësor, dhe rezistent në hapje.
6	Kapëse letrash flamur metal	33 mm	Kuti	30 Të jenë metalike me material cilësor.
7	Telapër kapëse 24/6	Kuti	60	Të jenë metalike me material cilësor.
8	Letër A4 Rizma	1608	- Letër fotokopje A4 (Një rizmë të ketë jo më pak se 500 fletë)	

- Pesha 80 gr/m?
- Përmasat 210 mm x 297 mm.

				- Të jetë e cilësisë së parë sipas certifikimit ISO CIE (ose ekuivalente)
				- Lëmueshmëria 80 - 100 ml/min. - Ambalazhimi:
				Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 rizma. -
				Lagështia: 3.5 % - 4.5 %.
				- Dukshmëria (drita) >= 95%. - Shkëlqimi: 101-104%
				- Bardhësia: 157 – 163.
				- Ashpërsia në përkulje: >110mN DM
				- Trashësia 104 - 112 ?m
				- Bardhësi: 152 - 160% dhe pa lustër
				- Të jetë multifunksionale - për fotokopje, printer, faks.
				- Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin,
fax-in				- Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit
				- Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit
				- Të plotësojnë standartet që letra të mbahet për kohë të gjatë në
arkivë.				- Të mos jetë e ricikluar
				- Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët
				- Të paraqitet një certifikate e letrës e cila pasqyron specifikimet e
saj.				
9	Stilolapsa Blu copë	200	Stilolapsa me kapak të thjeshtë, i veshur me material plastik, ngjyra blu	
10	Stilolapsa të kuqcopë plastik, ngjyra e kuqe	50	Stilolapsa me kapak të thjeshtë, i veshur me material plastik, ngjyra e kuqe	
11	Lapsa Plumbi HB	copë 60	Të jenë cilësor, grafit të standartit HB të zakonshëm	
12	Dosje me mekanizëm 5 cm	copë 30	Dosje me mekanizëm të jetë prej plastike, me trashësi 5 cm, përmasa afërsisht 31x29x5 cm (marzh gabimi 5%), të ketë të montuar bazamentin e fiksimit të dokumenteve.	
13	Dosje me mekanizëm 7 cm	copë 70	Dosje me mekanizëm A4 me kuti, 28x35x7 cm (marzh gabimi 5%), me kuti, me unazë metalike. Ngjyra e kutisë të jetë e njëjtë me ngjyrën e dosjes.	
14	Qese aktesh	Pako 100	Material plastik cilësor, format A4, me vrima. Të dizenuar për të mbajtur brenda letra format A4. Një pako përmban 100 zarfe.	
15	Blllok stiker	copë 40	Blllok shënimesh adesive 76x76, me 300 fletë me fletë me ngjyra	
16	Makinë kapëse 24/6	copë 30	Makinë kapëse aktesh 24/6, metal + plastike. Të kapë jo më pak se 25 fletë.	
17	Letër kase /printer termik (gjerësi 80 mm)	copë 400	Letër rulon për kasa /printer termik	
18	Ngjitës rulon	copë 20	Të jetë material cilësor	
19	Lagës gishti	copë 30	Tampon me sfungjer. Të jenë material cilësor	
20	Makinë llogaritëse	copë 30	Të kenë përmasa jo më të vogla se 147 x 225 mm dhe jo më pak se 12 Digit, të kenë çelës për fikje ndezje. Të jenë prodhim i certifikuar nga CE.	
21	Korrektor stilo	copë 30	Të jenë material cilësor.	

- 22 Prefëse lapsash copë 50 Të jenë material metalik ose plastik në trup, dhe teh cilësor në mprehjen e lapsave.
- 23 Vizore 30 cm copë 60 Të jenë cilësore me material plastik të tejdukshëm.
- 24 Dosje A4 zarfe plastike copë 20 Të jenë material plastik cilësor, me kapak dhe të pa depërtueshëm nga uji.
- 25 Dosje bene copë 120 Të jenë material cilësor, dhe me kapëse metalike brenda dosjes.
- 26 Heqëse telash copë 40 Të jenë material cilësor
- 27 Kit MK 1150 KYOCERA copë 3 Page yield 100,000 pages
Printer model ECOSYS M2040dn, ECOSYS M2135dn, ECOSYS M2540dn, ECOSYS M2635dn, ECOSYS M2640idw, ECOSYS M2735dw, ECOSYS P2040dn, ECOSYS P2040dw, ECOSYS P2235dn, ECOSYS P2235dw
- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.
- 28 TONER KYOCERA p 20-40 (TK 1160) copë 10 Kyocera TK-1160 Black Toner Cartridge (7,200 Pages) for Kyocera ECOSYS P2040 Printers.
Ensure your prints never dip in quality with the TK-1160 Black Toner Cartridge (7,200 Pages)
- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.
- 29 Toner HP 142 A për Printer HP Laserjet M109-M112 copë 2 HP 142A Black Original LaserJet Toner Cartridge, 950 pages, Black.
- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.
- 30 Toner HP 106A, për Printer HP MFP 135 A copë 2 Product subgroup: Standard Capacity Toner Cartridges
Color(s) of printing supplies: Black
Page yield (color): ~1,000 pages.
- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.
- 31 Toner MP 2501 për Printer Ricoh MP 2501SP copë 2 Ricoh MP 2501SP Black Toner Cartridge (Genuine) - Genuine Ricoh Brand - Estimated Yield 9,000 pages @ 6%.
- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.
- 32 Toner 51B00A0 për Printer Lexmark MS 317 dn copë 2 Lexmark 51B00A0, Black toner cartridge, compatible, 2500 standard pagës.
- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.
- 33 DRUM unit 50F0Z00 për Printer Lexmark MS 317 dn copë 2 50F0Z00 Compatible Image Unit Drum For Lexmark MS310 410 510 610 MX 310 410 415 510 511 610 611
- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.
- 34 Toner për Printer Lexmark MB 2236 copë 2 Toner cartridge, Type Manufacturer part # B220XA0 6000 faqe.
- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.
- 35 Image unit MB 2236 DW, B220Z00 copë 2 B220Z00 Imaging Unit
Estimated Yield
Up to: 12000 pages, based on 3 average letter/A4-size pages per print job and ~ 5% coverage
- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të

pajisjeve.

36 Genuine Ricoh Aficio MP 3352 Black Toner Cartridge copë 3 Ricoh Aficio MP 3352 Black Toner Cartridge (Genuine), Estimated 11,000 pages.

- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.

Sjellim në vëmendje të OE, se:

- Tonerat të jenë origjinale (të vërteta) të certifikuar, të prodhuesve të pajisjes për të cilin kërkohet/ose ekuivalent, me vulë origjinaliteti, të pahapura, jo të rimbushura, të verifikueshme nëpërmjet pullës së sigurisë, bar-kodit dhe numrit serial (në rastet kur aplikohet).
- Tonerat duhet të kenë garanci përdorimi deri në dy vjet nga koha e hyrjes në magazinën e AK.
- Tonerat duhet të kenë të gdhendur në trup emrin e tonerit përkatës të cilët janë element sigurie.
- Tonerat të jenë cilësore, në përputhje me standartet CE.
- Tonerat duhet të kenë shiritat mbrojtës, të cilët janë element sigurie dhe hiqen me përdorimin e parë.
- Tonerat të jenë të mbështjella në qese në mënyrë hermetike dhe të pahapura (duke plotësuar kushtet e ruajtjes së sigurt) dhe të ambalazhuara nëpër kuti, të shoqëruara këto me pulla sigurie nga prodhuesi.
- Transporti dhe fuqia e nevojshme punëtore për ngarkimin, shkarkimin dhe dorëzimin e artikujve në Magazinën qendrore të AK me adresë: Lagjja: “Mengël” Elbasan, do të bëhet nga OE.

Këto specifikime në lidhje me artikujt e lartpërmendur nuk e justifikojnë qëllimin për të cilin janë vendosur, pasi specifikime teknike të tilla nuk garantojnë cilësinë ose standartin e lartë për këtë produkt. Ndër të tjera konstatojmë se specifikimet teknike të artikujve të sipërpërmendur, të përcaktuara nga ana AK janë kufizuese, diskriminuese dhe nuk garantojnë të drejtën e operatorëve ekonomike të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Theksojmë se për të shmangur një situatë të tillë e cila të bën të mendosh se AK mund të adresojë në një markë të caktuar apo po kufizon konkurrencën, duhet të parashikoni specifikime për artikujt e mësipërm me një rang më të madh të parametrave duke përcaktuar një marzh me të gjerë specifikimesh e cila krijon mundësinë e ofertimit të artikujve të ndryshëm por gjithmonë cilësore nga operatorë ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, në lidhje me specifikimin teknik “Tonerat duhet të kenë të gdhendur në trup emrin e tonerit përkatës të cilët janë element sigurie” pretendojmë që ky specifikim nuk është i përshtatshëm për arritjen e synimit të autoritetit kontraktor, për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve, kjo pasi plotësimi i kërkesës së mësipërme varet nga vullneti i prodhuesve dhe jo i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për hartimin dhe dorëzimin e ofertave në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor.

Gjithashtu kërkojmë që AK të modifikojë kriterin pasi specifikimi teknik që “emri i tonerit të jetë i gdhendur në trup” nuk i takon domosdoshmërisht tonerit, pasi ai mund të jetë i vendosur në ambalazhin e tonerit ose në trupin e tonerit brenda ambalazhit, në varësi se si aplikohet nga prodhuesi dhe për autoritetin kontraktor e rëndësishme është, që pavarësisht mënyrës që prodhuesit zgjedhin për vendosjen e pullës së sigurisë, të garantohet që përmes produktit të ofruar, përmbushen kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara.

Pretendimi jonë bazohet në vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 68/2024 datë 19.01.2024.

Përsa i përket specifikimit “Tonerat të jenë cilësore, në përputhje me standartet CE”. Sic dihet,

vendi i prodhimit te produkteve, quhet vendi i origjines se tyre. Me kete kerkese, AK ka vendosur nje kufizim te origjines se produkteve, duke u kufizuar vetem ne produkte me origjine europiane, ne kundershtim kjo me parashikimet ligjore percaktuar ne LPP.

Kerkojme heqjen e ketij kufizimi

Në lidhje me artikullin nr. 8 “Letër A4” keni kërkuar 2 lloje të parametrin Bardhësia (Bardhësia: 157 – 163 si dhe Bardhësi: 152 - 160%). Përsa i përket këtij parametri kërkojmë nga ana e juaj përcaktimin se cili do të merret për bazë gjatë vlerësimit.

Gjithashtu referuar procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, gryojmë se autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht se si ndikojnë specifikimet teknike të atakuara nga ana jonë, në funksionalitetin e artikujve dhe çfarë pasojash sjell në përdorimin e këtij artikujve modifikimi i këtyre specifikimeve. Në këtë kuadër, pasi evidentuam gjithë bazën ligjore që është shkelur nga ana e Autoritetit Kontraktor në hartimin e këtyre specifikimeve lidhur me artikullin e lartpërmendur, pretendojmë, se autoriteti kontraktor duhet të pranojë pretendimet e sipëcekura në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Duke analizuar zë më zë artikujt e lartpërmendur, ne pretendojmë se vendosja e këtyre specifikimeve teknike bie në kundershtim siç vijon:

? Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 ‘Për prokurimin Publik’ përcaktohet se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjisllacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë, në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të

përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalejt “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalejt “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punë, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

Gjykojmë se, është e nevojshme të ndalemi në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike.

Nga interpretimi i zgjeruar i dispozitës së mësipërme sipas metodës Lex specialis, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, 2 Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrin operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të

rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, gjykojmë se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën.

Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pike 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit.

Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

? Gjithashtu vendosja e specifikimeve të tilla bie në kundërshtim me nenin 42 të

Direktive 24/2014 “Për prokurimin publik” Këshillit të Europës, ku parashikohet se:

“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojcës VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”.

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: specifikim teknik nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdoruesdhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED çështja C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mbretëria e Hollandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”

Ne gjykojmë se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për

shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

Në këtë kuadër, pasi evidentuam gjithë bazën ligjore që është shkelur nga ana e Autoritetit Kontraktor në hartimin e këtyre specifikimeve lidhur me artikullin e lartpërmendur, pretendojmë, se autoriteti kontraktor duhet të pranojë pretendimet e sipërcekura në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu referuar procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, gjuojmë se autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht se si ndikojnë specifikimet teknike të atakuara nga ana jonë, në funksionalitetin e artikujve dhe çfarë pasojash sjell në përdorimin e këtij artikujve modifikimi i këtyre specifikimeve. Në këtë kuadër, pasi evidentuam gjithë bazën ligjore që është shkelur nga ana e Autoritetit Kontraktor në hartimin e këtyre specifikimeve lidhur me artikullin e lartpërmendur, pretendojmë, se autoriteti kontraktor duhet të pranojë pretendimet e sipërcekura në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Për të gjitha sa u parashtruan më sipër, në zbatim dhe përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Direktiva nr. 24/2014 “Për prokurimin publik” Këshillit të Europës, Praktika e KPP-së (vendimi i KPP-së Nr. 200/2022, datë 25.02.2022, vendimi i KPP-së Nr. 675/2023, datë 26.07.2023, vendimi i KPP-së Nr. 485/2022, datë 25.04.2022, vendimi i KPP-së Nr. 543/2023, datë 29.06.2023, vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 68/2024 datë 19.01.2024), Njoftimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 8297/3 prot datë 23.01.2020 me lëndë “Njoftim”kërkojmë që Autoriteti Kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha dhe Komisioni i Prokurimit Publik, të ndryshojë kriterin e mësipërm si dhe specifikimet e artikujve të sipërpërmendur si të pabazuara në ligj dhe në prova në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,
Tiranë me 11.03.2024

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po Jo
? X

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

JO

7. Lista e informacionit konfidencial:

NA

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Nr. i faksit:

E-mail:

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Shoqëria “Interlogistic” Sh.p.k me Nipt K21605003M përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm Z. Edmond Hido, në vijim të procedurës së prokurimit publik “Procedure e hapur e thjeshtuar”, shpallur nga Autoriteti Kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sha, me objekt: “Blerje materiale kancelarie për nevojat e shoqërisë”, me numer REF-97735-03-07-2024, me fond limit 1,499,600.66 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind presje gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë, pa TVSH, publikuar më datë 08.03.2024, referuar në afatin 7 (shtatë) ditor të parashikuar nga Ligji nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” konkretisht Neni 110 pika 2 i cili citon “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”, lidhur me të drejtën e ankimit pas publikimit të dokumenteve standarte të tenderit, po ju parashtrijmë në vijim arsyet ligjore ku bazohen këto kundërshtime:

? Në shtojcën nr. 6 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” të dokumenteve standarte të tenderit është kërkuar afati i levrimit nga ana Juaj si më poshtë:

Afatet e lëvrimit: Brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në lidhje me sa është kërkuar nga ana e juaj, pretendojmë se ky afat është tepër i shkurtër, kjo pasi bëhet fjalë për furnizimin me sasi të konsiderueshme të artikujve (kancelari, letër si dhe tonera) të cilët importohen nga furnitorë? te? ndryshe?m nde?rkombe?tare?. Duke qe?ne? se operatorët ekonomik për artikujt objekt prokurimi i kësaj procedure duhet të marrin furnizimin nga furnitorë të huaj dhe duke marrë në konsideratë kushtet aktuale globale të shkaktuara nga Pandemia Covid-19, lufta në Ukrainë si dhe lufta në Palestinë, kaosi i shkaktuar lidhur me transportin dhe rritja shumë e madhe e çmimeve të tij, e bëjnë shumë të vështirë që malli të merret nga jashtë shtetit dhe të lëvrohet në adresën tuaj brenda afatit të përcaktuar në DST. Të ndodhur në kushtet e krizës botërore për sa i përket transportit dhe lëvrimit të mallrave, kërkojmë që afati i lëvrimit të jetë minimalisht 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës. Theksojmë se kërkesa e AK është në shkëlqje të Ligjit LPP dhe Neni 40 të Rregullave të Prokurimit Publik. Për të gjitha sa u parashtruan mësipër, në zbatim dhe pë?rputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Vendimin nr.285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, kërkojmë që Autoriteti Kontraktor dhe Komisioni i Prokurimit Publik, të ndryshojë kriterin e mesiperm si të pabazuar në ligj dhe në prova”.

Ky pretendim i joni ligjerohet dhe nga vendimi i KPP-së Nr. 200/2022, datë 25.02.2022, vendimi i KPP-së Nr. 675/2023, datë 26.07.2023

? Në shtojcën nr. 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumenteve standarte të tenderit është kërkuar si më poshtë:

“2.3.1 Në datën dhe orën e hapjes së ofertave, çdo OE pjesëmarrës, duhet të paraqesë mostrat e kërkuara nga AK, sipas tabelës në Shtojcën 5.

Mosparaqitja e mostrave, apo paraqitja e mostrave që nuk përputhen me specifikimet teknike, përbën kusht për s’kualifikim”

Nga sa më sipër në lidhje me këtë kriter theksojmë faktin se Autoriteti Juaj kontraktorë nuk mund të kërkojë që operatorët ekonomik të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, të paraqesin në datën dhe orën e caktuar mostra për të gjithë artikujt. Në bazë të ligjit të prokurimeve në fuqi autoriteti kontraktor për të garantuar mallra/produkte konformë standardeve që përcaktojnë kanë të drejtë të kërkojnë që produktet e caktuara të sillen si mostra, por në asnjë rast nuk jep të drejtën e autoriteteve kontraktore të kërkojnë mostra për të gjitha produktet të cilat edhe në sasi, në kuptimin e lëvrimit të mallrave në përfundim të procedurës së prokurimit, janë në sasi të vogla. Nuk ka sens logjik dhe as juridik paraqitja e mostrave për të gjithë artikujt e kërkuar. Në këtë aspekt ky përcaktim i bërë në DST vjen në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore të prokurimeve të janë në fuqi.

Ky pretendim i joni përcaktohet dhe nga vendimi i KPP-së Nr. 485/2022, datë 25.04.2022.

? Në shtojcën nr. 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumenteve standarte të tenderit është kërkuar si më poshtë:

“2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetim/deklarate/autorizim prodhuesi ose të distributorit të autorizuar për artikujt e kancelarisë, bojë printeri (toner) dhe letrën. Dokumentet duhet të përmbajnë të dhëna të plota si: telefoni/e-mail/website, të nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij”

Në lidhje me kriteret e lartcekura, të kërkuar nga ana e juaj, gjukojmë që janë kërkesa të ekzagjeruar, kufizuese dhe jo në proporcion me objektin e kontrates.

Për të realizuar këto kërkesë, OE pjesëmarrës, duhet të bashkëpunojnë vetëm me prodhuesit apo me distributorët e autorizuar. Nderkohë, referuar artikujve të publikuar, objekt prokurimi kemi të bëjmë me artikuj të imet e të thjeshtë kancelarie, të cilat mund të sigurohen lehtësisht nga furnitorë të pafund, të cilat nuk operojnë mbi baza distribucioni si dhe nuk kanë katalogje të publikuara. Kërkesa për katalogje apo skedë teknike, nga prodhuesi apo distributor i autorizuar, ka kuptim dhe është përdorur nga shumë AK, për artikullin letër fotokopje/printimi, pasi specifikimet teknike të kërkuara për këtë produkt, nuk verifikohen dot me sy të lirë nga AK. Ndërsa për produktet e thjeshta të kancelarisë, AK kanë të gjithë instrumentat, që të verifikojnë përputhjen e produkteve të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara. Ju sjellim në vëmendje Rekomandimin mbi hartimin e kritereve të kualifikimit për procedurat e prokurimit punëra, mallra, shërbime nga APP të datës 24.12.2021, ku APP përcakton në pikën 16 se “për procedurat e hapura të thjeshtuara, si procedura në fjale, AK duhet të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi. Së fundmi, sjellim në vëmendje të autoriteteve/enteteve kontraktore se në rastin e procedurave të hapura të thjeshtuara, të përcaktojnë kritere sa më të thjeshta pranimi, për operatorët ekonomike, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm, duke mbajtur në vëmendje përcaktimet e nenit 55, pika 4, të RRPP, ku parashikohet: Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kriteret e sipërcituara, jo vetëm që nuk nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencen e lirë, por perkundrazi, kufizojnë pjesëmarrjen, pasi lejojnë të

marrin pjesë vetem OE që furnizohen nga prodhuesit apo distributorët e autorizuar. Këto kërkesa nuk lidhen me garantimin e cilësisë. Për këtë arsye, kërkojmë modifikimin e këtyre kriterëve.

Ky pretendim i joni përcaktohet dhe nga vendimi i KPP-së Nr. 543/2023, datë 29.06.2023.

Gjithashtu shtojmë se në lidhje me kërkesën për autorizimin e prodhuesit për artikujt Tонера është në kundërshtim përsa vijon më poshtë.

Ky kriter kualifikues ku operatori ekonomik duhet të vertetojë që është i autorizuar nga prodhuesi ose nga distributorët e autorizuar për tregtimin e brandeve që janë pjesë e këtij prokurimi, është një kriter që në bazë të vendimit të formës së prerë si mëposhtë është i ndaluar:

Duke ju referuar vendimit nr. 00-2015(42) datë 23.01.2015, Gjykata e Lartë në çështjen administrative me palë paditëse shoqëria Marketing & Distribution sh.p.k, palë të paditur Komisionin e Prokurimit Publik dhe me palë të tretë Ministrinë e Brendshme me objekt shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik dhe të procedurave të prokurimit publik Blerje toner për Kryeministrinë, Ministrinë dhe institucionet në varësi të tyre, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik që kishte rrëzuar ankimin e operatorit ekonomik Marketing & Distribution Sh.p.k i cili kundërshtonte kriterin kualifikues të Formës së Autorizimit nga Prodhuesi.

Në paragrafin 33 të vendimit të Gjykatës së Lartë për një rast precedent, bashkëngjitur kësaj kërkesë, Gjykata e Lartë thekson që sipas neneve 20, 23 dhe 46 të ligjit nr 9643/2006, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se autoritetet kontraktore gjatë percaktimit të kriterëve të veçanta duhet të shmangin cdo kërkesë apo procedurë që lidhet me kualifikimin e operatoreve ekonomike, e cila përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktoreve ose ndaj kategorive të tyre. [...] Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpermendura, urdhërojnë se percaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Gjykata vijon në paragrafin 37 duke u shprehur se Duke u kthyer në rastin konkret evidentohet se kriteri objekt kundërshtimi nga pala paditëse "paraqitja e formës së autorizimit nga prodhuesi nuk plotëson kushtet për të qënë një kriter specifik kualifikues në përputhje me ligjin.

Sipas Gjykatës së Lartë origjinaliteti i bojerave mund të vërtetohet me dokumenta ekuivalente: vërtetimi i origjinalitetit të bojerave [...] mund të garantohej me pajisjen e tyre me vulën e origjinalitetit të pahapur dhe jo të rimbushura" duke vijuar në paragrafin 38 të vendimit që kërkesa për paraqitjen e formës së autorizimit nga prodhuesi si kriter kualifikues, nuk mund të jetë i vetmi mjet që të mundësojë garantimin e origjinalitetit të mallit, kjo duke e mbështetur argumentimin e saj edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian në çështjen Procureur du Roi v. Dassonville 1974.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se mospërzgjedhja - e kriterit të veçantë Forma e Autorizimit nga Prodhuesit në përputhje me të gjithë elementet që e detyron ligji në çështjen objekt gjykimi ka bërë që autoriteti kontraktor të duket sikur e ka parazgjedhur paraprakisht kandidatin fitues, ç'ka bie ndesh me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik në Republikën e Shqipërisë".

Duke iu referuar Vendimit të Gjykatës dhe arsyetimit të tyre ligjorë, kërkojmë nga ana e Autoritetit Kontraktor të ndryshojë Dokumentat Standarte të Tenderit duke revokuar kriterin kualifikues ku operatori ekonomik duhet të vertetojë që është i autorizuar nga prodhuesi dhe nga distributori i autorizuar.

Gjithashtu duke ju referuar ligjit të prokurimit i cili në thelb ka për qëllim të nxisë pjesëmarrjen dhe të trajtojë të gjithë OE në mënyrë të barabartë, ky kriter shihet më shumë si favorizues për ndonjë OE sesa vertetues i produkteve të kërkuara. Ky kriter e pamundëson pjesëmarrjen në tender të shumë ofertuesve. Autoriteti Kontraktor ka mënyra të tjera për të vërtetuar origjinalitetin e

produkteve si:

1. Vertetohet me anë të pullës së sigurisë së markës që është unike.
2. Kodi OEM i cili është unik dhe i stampuar në kuti
3. Duke kërkuar deklaratë origjinaliteti për produktin (nga ku rrjedh dhe detyrimi i OE, që produktet në raste të fitimit të tenderit të jenë konform, dhe nga ku lind dhe siguria e juaj për produktet që do të merrni në dorezim)
4. Duke kërkuar katalog teknik për produktet që kërkohen
5. Duke marrë eksperte të jashtëm të liçensuar për këtë qëllim

Në funksion të heqjes së kriterit të sipërcituar kemi edhe praktikën e KPP-së konkretisht referuar Vendimit KPP-së, nr. 222/2017, (bashkëkangjitur formatit të ankesës) ku ky i fundit i referohet Vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ka vendosur që kriteret të tilla si: autorizim prodhuesi i distributori të autorizuar janë diskriminuese, jo në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe si të tilla, duhet të hiqen.

Gjithashtu referuar dhe Vendimit KPP-së nr. 128/2020, vendim i cili shprehimisht e sheh këtë kriter si një kriter që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe vendos heqjen e këtij kriteri nga procedura e prokurimit.

Agjencia e Prokurimit publik, në funksion të heqjes së autorizimit të prodhuesit ose distributorit të autorizuar, me shkresën nr. 4521/2 prot datë 23.07.2021, drejtuar operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” shpk është shprehur konkretisht: “APP ka rekomanduar autoritetet kontraktore që, autorizimi i prodhuesit/distributorit të autorizuar nga prodhuesi është një prej mundësive që dëshmon origjinalitetin e mallrave, por në çdo rast ky autorizim nuk duhet të lidhet me një marke/prodhues të caktuar, me qëllim që të mos kufizohet pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë që ofrojnë mallrat e prodhuesve të ndryshëm nga prodhuesi i pajisjes, por që janë të përshtatshme në pajisjet që disponon autoriteti kontraktor”

Së fundmi duke iu referuar dhe Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 21.10.2020 me numër prot. 6732, me lëndë “Mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të Dokumenteve Standarte të Tenderit dhe verifikimit të procedurave të prokurimit për mallra, punë, shërbime” rekomandim i cili shprehimisht ndalon kërkimin e dokumentacionit të paleve të treta që nuk janë pjesë e konkurimit në procedurën që po aplikohet.

Sa më sipër kërkojmë heqjen e kërkesës për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit të prodhuesit për artikullin toner si dhe kancelari.

Vendosja e një kriteri të tillë bie në kundërshtim;

? Në nenin 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

? Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për

operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

? Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Nga interpretimi i bazës ligjore të sipercituar, kriteret për kualifikim vendosen për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Modifikimi i kriterit të lartpërmendur nga ana e autoritetit bën të mundur shmangien në kufizimin e konkurrueshmërisë duke mundësuar një konkurrim të drejtë, të hapur dhe sa më gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminuese për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar.

? Gjithashtu në shtojcën 5 “Specifikimet teknike” është kërkuar nga ana Juaj si më poshtë:
SPECIFIKIMET TEKNIKE

KËRKESAT PËR ARTIKUJT E NEVOJSHËM DHE SPECIFIKIMET PËRKATËSE

Nr.	Emërtimi i artikujve	Njësia	Sasia	Specifikime	
1	Makinë hapëse vrimash jo më pak se 30 fletë mundësojë hapjen e jo më pak se 30 fletë njëherësh	copë	20	Të jetë cilësore, dhe të	
2	Kapëse me veshë 41 mm	copë	100	Të jenë cilësore, material metali sustë.	
3	Kapëse me veshë 51 mm	copë	60	Të jenë cilësore, material metali sustë.	
4	Gomë fshirëse	copë	30	Të jenë cilësore në fshirjen e bojës së stilolapsave dhe të lapsave.	
5	Llastik lekësh	pako	20	Të jenë material cilësor, dhe rezistent në hapje.	
6	Kapëse letrash flamur metal	33 mm	Kuti	30	Të jenë metalike me material cilësor.
7	Telapër kapëse 24/6	Kuti	60	Të jenë metalike me material cilësor.	
8	Letër A4	Rizma	1608	- Letër fotokopje A4 (Një rizmë të ketë jo më pak se 500 fletë)	
				- Pesha 80 gr/m? - Përmasat 210 mm x 297 mm. - Të jetë e cilësisë së parë sipas certifikimit ISO CIE (ose ekuivalente)	
				- Lëmueshmëria 80 - 100 ml/min. - Ambalazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 rizma. - Lagështia: 3.5 % - 4.5 %.	
				- Dukshmëria (drita) > = 95%. - Shkëlqimi: 101-104% - Bardhësia: 157 – 163. - Ashpërsia në përkulje: >110mN DM - Trashësia 104 - 112 ?m - Bardhësi: 152 - 160% dhe pa lustër - Të jetë multifunksionale - për fotokopje, printer, faks. - Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin,	
	fax-in			- Të qëndrojë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit - Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit - Të plotësojë standartet që letra të mbahet për kohë të gjatë në	
	arkivë.			- Të mos jetë e ricikluar - Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët - Të paraqitet një certifikate e letres e cila pasqyron specifikimet e	
	saj.				
9	Stilolapsa Blu	copë	200	Stilolapsa me kapak të thjeshtë, i veshur me material plastik, ngjyra blu	
10	Stilolapsa të kuqcopë	50		Stilolapsa me kapak të thjeshtë, i veshur me material plastik, ngjyra e kuqe	
11	Lapsa Plumbi HB	copë	60	Të jenë cilësor, grafit të standartit HB të zakonshëm	
12	Dosje me mekanizëm 5 cm	copë	30	Dosje me mekanizëm të jetë	

prej plastike, me trashësi 5 cm, përmasa afërsisht 31x29x5 cm (marzh gabimi 5%), të ketë të montuar bazamentin e fiksimit të dokumenteve.

13 Dosje me mekanizëm 7 cm copë 70 Dosje me mekanizëm A4 me kuti, 28x35x7 cm (marzh gabimi 5%), me kuti, me unazë metalike. Ngjyra e kutisë të jetë e njëjtë me ngjyrën e dosjes.

14 Qese aktesh Pako 100 Material plastik cilësor, format A4, me vrima. Të dizenuar për të mbajtur brenda letra format A4. Një pako përmban 100 zarfe.

15 Bllok stiker copë 40 Bllok shënimesh adesive 76x76, me 300 fletë me fletë me ngjyra

16 Makinë kapëse 24/6 copë 30 Makinë kapëse aktesh 24/6, metal + plastike. Të kapë jo më pak se 25 fletë.

17 Letër kase /printer termik (gjerësi 80 mm) copë 400 Letër rulon për kasa /printer termik

18 Ngjitës rulon copë 20 Të jetë material cilësor

19 Lagës gishti copë 30 Tampon me sfungjer. Të jenë material cilësor

20 Makinë llogaritëse copë 30 Të kenë përmasa jo më të vogla se 147 x 225 mm dhe jo më pak se 12 Digit, të kenë çelës për fikje ndezje. Të jenë prodhim i certifikuar nga CE.

21 Korrektor stilo copë 30 Të jenë material cilësor.

22 Prefëse lapsash copë 50 Të jenë material metalik ose plastik në trup, dhe te cilësor në mprehjen e lapsave.

23 Vizore 30 cm copë 60 Të jenë cilësore me material plastik të tejdukshëm.

24 Dosje A4 zarfe plastike copë 20 Të jenë material plastik cilësor, me kapak dhe të pa depërtueshëm nga uji.

25 Dosje bene copë 120 Të jenë material cilësor, dhe me kapëse metalike brenda dosjes.

26 Heqëse telash copë 40 Të jenë material cilësor

27 Kit MK 1150 KYOCERA copë 3 Page yield 100,000 pages

Printer model ECOSYS M2040dn, ECOSYS M2135dn, ECOSYS M2540dn, ECOSYS M2635dn, ECOSYS M2640idw, ECOSYS M2735dw, ECOSYS P2040dn, ECOSYS P2040dw, ECOSYS P2235dn, ECOSYS P2235dw

- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.

28 TONER KYOCERA p 20-40 (TK 1160) copë 10 Kyocera TK-1160 Black Toner Cartridge (7,200 Pages) for Kyocera ECOSYS P2040 Printers.

Ensure your prints never dip in quality with the TK-1160 Black Toner Cartridge (7,200 Pages)

- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.

29 Toner HP 142 A për Printer HP Laserjet M109-M112 copë 2 HP 142A Black Original LaserJet Toner Cartridge, 950 pages, Black.

- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.

30 Toner HP 106A, për Printer HP MFP 135 A copë 2 Product subgroup: Standard Capacity Toner Cartridges

Color(s) of printing supplies: Black

Page yield (color): ~1,000 pages.

- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.

31 Toner MP 2501 për Printer Ricoh MP 2501SP copë 2 Ricoh

MP 2501SP Black Toner Cartridge (Genuine) - Genuine Ricoh Brand - Estimated Yield 9,000 pages @ 6%.

- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.

32 Toner 51B00A0 për Printer Lexmark MS 317 dn copë 2 Lexmark 51B00A0, Black toner cartridge, compatible, 2500 standard pagës.

- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.

33 DRUM unit 50F0Z00 për Printer Lexmark MS 317 dn copë 2 50F0Z00 Compatible Image Unit Drum For Lexmark MS310 410 510 610 MX 310 410 415 510 511 610 611

- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.

34 Toner për Printer Lexmark MB 2236 copë 2 Toner cartridge, Type Manufacturer part # B220XA0 6000 faqe.

- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.

35 Image unit MB 2236 DW, B220Z00 copë 2 B220Z00 Imaging Unit Estimated Yield

Up to: 12000 pages, based on 3 average letter/A4-size pages per print job and ~ 5% coverage

- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.

36 Genuine Ricoh Aficio MP 3352 Black Toner Cartridge copë 3 Ricoh Aficio MP 3352 Black Toner Cartridge (Genuine), Estimated 11,000 pages.

- E pa hapur, me Qr Code që tregon origjinalitetin e produktit sipas kompanisë prodhuese të pajisjeve.

Sjellim në vëmendje të OE, se:

- Tonerat të jenë origjinale (të vërteta) të certifikuar, të prodhuesve të pajisjes për të cilin kërkohet/ose ekuivalent, me vulë origjinaliteti, të pahapura, jo të rimbushura, të verifikueshme nëpërmjet pullës së sigurisë, bar-kodit dhe numrit serial (në rastet kur aplikohet).

- Tonerat duhet të kenë garanci përdorimi deri në dy vjet nga koha e hyrjes në magazinën e AK.

- Tonerat duhet të kenë të gdhendur në trup emrin e tonerit përkatës të cilët janë element sigurie.

- Tonerat të jenë cilësore, në përputhje me standartet CE.

- Tonerat duhet të kenë shiritat mbrojtës, të cilët janë element sigurie dhe hiqen me përdorimin e parë.

- Tonerat të jenë të mbështjella në qese në mënyrë hermetike dhe të pahapura (duke plotësuar kushtet e ruajtjes së sigurt) dhe të ambalazuara nëpër kuti, të shoqëruara këto me pulla sigurie nga prodhuesi.

- Transporti dhe fuqia e nevojshme punëtore për ngarkimin, shkarkimin dhe dorëzimin e artikujve në Magazinën qendrore të AK me adresë: Lagjja: “Mengël” Elbasan, do të bëhet nga OE.

Këto specifikime në lidhje me artikujt e lartpërmendur nuk e justifikojnë qëllimin për të cilin janë vendosur, pasi specifikime teknike të tilla nuk garantojnë cilësinë ose standartin e lartë për këtë produkt. Ndër të tjera konstatojmë se specifikimet teknike të artikujve të sipërpërmendur, të përcaktuara nga ana AK janë kufizuese, diskriminuese dhe nuk garantojnë të drejtën e operatorëve ekonomike të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Theksojmë se për të shmangur një situatë të tillë e cila të bën të mendosh se AK mund të adresojë në një markë të caktuar apo po kufizon konkurrencën, duhet të parashikoni specifikime për artikujt

e mësipërm me një rang më të madh të parametrave duke përcaktuar një marzh me të gjerë specifikimesh e cila krijon mundësinë e ofertimit të artikujve të ndryshem por gjithmonë cilësore nga operatorë ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, në lidhje me specifikimin teknik “Tonerat duhet të kenë të gdhendur në trup emrin e tonerit përkatës të cilët janë element sigurie” pretendojmë që ky specifikim nuk është i përshtatshëm për arritjen e synimit të autoritetit kontraktor, për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve, kjo pasi plotësimi i kërkesës së mësipërme varet nga vullneti i prodhuesve dhe jo i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për hartimin dhe dorëzimin e ofertave në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor.

Gjithashtu kërkojmë që AK të modifikojë kriterin pasi specifikimi teknik që “emri i tonerit të jetë i gdhendur në trup” nuk i takon domosdoshmërisht tonerit, pasi ai mund të jetë i vendosur në ambalazhin e tonerit ose në trupin e tonerit brenda ambalazhit, në varësi se si aplikohet nga prodhuesi dhe për autoritetin kontraktor e rëndësishme është, që pavarësisht mënyrës që prodhuesit zgjedhin për vendosjen e pullës së sigurisë, të garantohet që përmes produktit të ofruar, përmbushen kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara.

Pretendimi jonë bazohet në vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 68/2024 datë 19.01.2024.

Përsa i përket specifikimit “Tonerat të jenë cilësore, në përputhje me standartet CE”. Sic dihet, vendi i prodhimit të produkteve, quhet vendi i origjines se tyre. Me kete kerkese, AK ka vendosur nje kufizim te origjines se produkteve, duke u kufizuar vetem ne produkte me origjine europiane, ne kundërshtim kjo me parashikimet ligjore përcaktuar ne LPP.

Kerkojme heqjen e ketij kufizimi

Në lidhje me artikullin nr. 8 “Letër A4” keni kërkuar 2 lloje të parametrave Bardhësia (Bardhësia: 157 – 163 si dhe Bardhësi: 152 - 160%). Përsa i përket këtij parametri kërkojmë nga ana e juaj përcaktimin se cili do të merret për bazë gjatë vlerësimit.

Gjithashtu referuar procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, gjukojmë se autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht se si ndikojnë specifikimet teknike të atakuara nga ana jonë, në funksionalitetin e artikujve dhe çfarë pasojash sjell në përdorimin e këtij artikujve modifikimi i këtyre specifikimeve. Në këtë kuadër, pasi evidentuam gjithë bazën ligjore që është shkelur nga ana e Autoritetit Kontraktor në hartimin e këtyre specifikimeve lidhur me artikullin e lartpërmendur, pretendojmë, se autoriteti kontraktor duhet të pranojë pretendimet e sipëcekura në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Duke analizuar zë më zë artikujt e lartpërmendur, ne pretendojmë se vendosja e këtyre specifikimeve teknike bie në kundërshtim siç vijon:

? Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” përcaktohet se:

“1.Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurorët.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të

drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë, të njohur dhe të përcaktuar në ofertuesve të

pe?rcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si të njohur dhe të përcaktuar në ofertuesve të funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të

shoqërohet nga fjalejt “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalejt “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshkrimit që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

Gjykojmë se, është e nevojshme të ndalemi në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike.

Nga interpretimi i zgjeruar i dispozitës së mësipërme sipas metodës Lex specialis, autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të

gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, 2 Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, gjykojmë se, ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike.

Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën.

Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve.

Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikeve 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit.

Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

? Gjithashtu vendosja e specifikimeve të tilla bie në kundërshtim me nenin 42 të

Direktiveve 24/2014 “Për prokurimin publik” Këshillit të Europës, ku parashikohet se:

“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”.

Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: specifikim teknik nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdoruesudhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED çështja C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mbretëria e Hollandës” inter alia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”

Në gjykojmë se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

Në këtë kuadër, pasi evidentuam gjithë bazën ligjore që është shkelur nga ana e Autoritetit Kontraktor në hartimin e këtyre specifikimeve lidhur me artikullin e lartpërmendur, pretendojmë, se autoriteti kontraktor duhet të pranojë pretendimet e sipërcekura në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu referuar procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, gjykojmë se autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht se si ndikojnë specifikimet teknike të atakuara nga ana jonë, në funksionalitetin e artikujve dhe çfarë pasojash sjell në përdorimin e këtij artikujve modifikimi i këtyre specifikimeve. Në këtë kuadër, pasi evidentuam gjithë bazën ligjore që është shkelur nga ana e Autoritetit Kontraktor në hartimin e këtyre specifikimeve lidhur me artikullin e lartpërmendur, pretendojmë, se autoriteti kontraktor duhet të pranojë pretendimet e sipërcekura në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Për të gjitha sa u parashtruan më sipër, në zbatim dhe përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Direktiva nr. 24/2014 “Për prokurimin publik” Këshillit të Europës, Praktika e KPP-së (vendimi i KPP-së Nr. 200/2022, datë 25.02.2022, vendimi i KPP-së Nr. 675/2023, datë 26.07.2023, vendimi i KPP-së Nr. 485/2022, datë 25.04.2022, vendimi i KPP-së Nr. 543/2023, datë 29.06.2023, vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 68/2024 datë 19.01.2024), Njoftimi i Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 8297/3 prot datë 23.01.2020 me lëndë “Njoftim”kërkojmë që Autoriteti Kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime

Elbasan sha dhe Komisioni i Prokurimit Publik, të ndryshojë kriterin e mësipërm si dhe specifikimet e artikujve të sipërpërmendur si të pabazuara në ligj dhe në prova në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,
Tiranë me 11.03.2024

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po Jo
? X

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonti)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

_____ JO _____

7. Lista e informacionit konfidencial:

_____ NA _____

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Nr. i faksit:

E-mail:

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

JO

7. Lista e informacionit konfidencial:

NA

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

hido.ed@ilog.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Edmond Hido

